

UDHËZIM
Nr. 5, datë 3.2.2022

**PËR PROGRAMIN, TRAJNIMIN, TESTIMIN DHE LËSHIMIN E
CERTIFIKATËS PËR KËSHILLTARËT E SIGURISË NË TRANSPORTIN E
MALLRAVE TË RREZIKSHME DHE TARIFAT PËRKATËSE**

(ndryshuar me udhëzimin nr. 14, datë 2.11.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; neneve 28, 29, 30, 31 të ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”; neneve 115/1, 119, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 68, të ligjit nr. 142, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZON:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim hartimin e programit të formimit profesional, mënyrën e trajnimit dhe të vlerësimit të këshilltarëve të sigurisë, si dhe formën dhe vlefshmërinë e certifikatës së trajnimit profesional të tyre. Gjithashtu, në këtë udhëzim përcaktohen lista e lëndëve ose e çështjeve që duhet të trajtohen, sipas programeve të trajnimit, përmbajtja dhe mënyra e kryerjes së testeve, përbërja e komisionit të caktuar për kryerjen e testimit, si dhe tarifat e trajnimit.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij udhëzimi aplikohen ndaj të gjitha subjekteve me objekt veprimtarie transportin rrugor, hekurudhor dhe/ose të kombinuar të mallrave të rrezikshme, brenda vendit dhe ndërkombëtarë, në zbatim të ligjit nr. 118, datë 13.12.2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, ADR-së dhe RID-it.

Neni 3

Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr. 118/2012, datë 13.12.2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, si dhe termat e tjerë, që përdoren në tekstin e këtij udhëzimi, kanë kuptim, si më poshtë:

2. “Autoriteti përgjegjës” nënkupton ministrinë që mbulon veprimtarinë në fushën e transportit.

3. “Institucion trajnimi”, nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rugor (DPSHTRR) për transportin rrugor dhe Qendrat e Formimit Profesional në fushën e transportit hekurudhor.

4. Togfjalëshat:

a) “Ligji për transportin e mallrave të rrezikshme” nënkupton ligjin nr. 118/2012, datë 13.12.2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”;

b) “Kodi Hekurudhor” nënkupton ligjin nr. 142, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

5. “ADR” nënkupton anekset A dhe B të “Marrëveshjen për Transportin Ndërkombëtar Rugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR)”¹.

¹ Që nga 1 janari 2021 “Marrëveshja Evropiane për Transportin Ndërkombëtar Rugor të Mallrave të Rrezikshme

6. “Subjekt” nënkupton një sipërmarrje, transportues, person fizik ose juridik, e cila/i cili në veprimtarinë e saj/tij përfshin transportin ose veprimtaritë e lidhura me ambalazhimin (paketimin), mbushjen, ngarkimin ose shkarkimin e mallrave të rrezikshme.

7. “RID” nënkupton rregullat në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Hekurudhë² (RID), shtojca C e Konventës, në lidhje me Transportin Ndërkombëtar me Hekurudhë (COTIF).

8. “Transport i kombinuar” nënkupton përcaktimin³, sipas nenit 5, pika 69, të Kodit Hekurudhor.

Neni 4

Caktimi i këshilltarëve të sigurisë

1. Subjektet, të cilat në veprimtarinë e tyre përfshijnë dorëzimin ose transportin e mallrave të rrezikshme në mjetet rrugore, në vagonët hekurudhorë dhe në njësitë e transportit të kombinuar ose të lidhura me ambalazhimin, ngarkimin, mbushjen ose shkarkimin, do të caktojnë një ose më shumë këshilltarë të sigurisë për transportin e mallrave të rrezikshme, përgjegjës për të ndihmuar në parandalimin e rreziqeve të mundshme në të tilla veprimtari, në lidhje me njerëzit, kapacitetet, pronën dhe mjedisin.⁴

2. Këshilltarë sigurie mund të jenë të vetëpunësuarit, punëmarrësit apo persona të tjerë.

Në rastet kur në një subjekt caktohen më shumë se një këshilltar sigurie, duhet të sigurohet bashkëpunimi midis këshilltarëve të sigurisë.

3. Subjektet përkatëse të përcaktojnë:

a) numrin e nevojshëm të këshilltarëve për të kryer detyrat me efikasitet, në varësi edhe të numrit të mjeteve dhe/ose të drejtuesve të mjeteve të transportit të mallrave të rrezikshme;

b) kohën e duhur që u nevojitet këshilltarëve të sigurisë;

c) aksesin e nevojshëm në dokumentet e subjekteve, referuar ADR-së dhe RID-it dhe/ose transportit të kombinuar etj.

4. Subjekti nuk duhet të caktojë një person si këshilltar të sigurisë ose të lejojë vazhdimin e ushtrimit të veprimtarisë si e tillë, nëse nuk është pajisur me një certifikatë të vlefshme (në këtë udhëzim referuar si “certifikatë trajnimi”), të lëshuar në emër të tij nga institucioni i trajnimit.

Neni 5

Përjashtimet

1. Detyrimi për të caktuar një ose disa këshilltarë të sigurisë të mallrave të rrezikshme nuk zbatohet, për:

a) veprimtaritë që lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe të forcave të armatosura të shteteve të tjera, në përputhje me marrëveshjen/marrëveshjet në fuqi;

b) veprimtaritë kryesore ose dytësore të të cilave nuk janë transportimi ose ambalazhimi, mbushja, ngarkimi ose shkarkimi i mallrave të rrezikshme, por që rastësisht angazhohen në transportin kombëtar lidhur me ambalazhimin, mbushjen, ngarkimin ose shkarkimin e mallrave të rrezikshme, duke paraqitur rrezikshmëri të ulët për dëmtimin ose ndotjen e ambientit;

(ADR)”, bëhet “Marrëveshja për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR)”.

² Në fuqi nga 1 janari 2021, kërkesat hekurudhore zëvendësuan ato të datës 1.1.2019, në lidhje me Rregullat lidhur me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Hekurudhë (RID), shtojca C e Konventës, në lidhje me Transportin Ndërkombëtar me Hekurudhë (COTIF).

³ Transport i kombinuar është transporti intermodal, përshkimi kryesor i të cilit kryhet me hekurudhë, me linjat e brendshme ujore ose me transport detar dhe vetëm përshkimi fillestar dhe/ose fundor kryhet me transport rrugor, sa më shkurt të jetë e mundur.

⁴ Referuar pikës 1.6.1.44, të Marrëveshjes ADR dhe rregullores RID (të aplikueshme nga 1 janari 2021), subjektet, të cilat marrin pjesë në transportin e mallrave të rrezikshme, vetëm si dorëzues/dërgues dhe që nuk kanë caktuar një këshilltar sigurie bazuar në dispozitat e aplikueshme deri më 31 dhjetor 2018, do të caktojnë një këshilltar sigurie jo më vonë se 31 dhjetor 2022, pas heqjes nga dispozitat e pikës 1.8.3.1 të aplikueshme nga 1 janari 2019.

c) veprimtaritë e të cilave, sasitë për çdo njësi transporti dhe vagon hekurudhor të mallrave të rrezikshme, nuk kalojnë ato të përcaktuara në ADR dhe në RID, përkatësisht pikat 1.1.3.6, 1.7.1.4 (kapitujt 1.1, 1.7) dhe në kapitujt 3.3, 3.4 dhe 3.5, përjashtimeve sipas:

i. 1.1.3.6 ose 3.4 (të cilat lidhen me sasitë më të vogla në çdo njësi transporti se ato të cituara në kapitujt e përmendur dhe lidhur me sasinë e transportuar në pako-cisterna dhe sasi të mëdha që nuk përfshihen);

ii. 1.7.1.4 (disa materiale radioaktive);

iii. 3.3 (dispozita të veçanta);

iv. 3.4 (mallrat e rrezikshme të paketuara në sasi të kufizuara);

v. 3.5 (mallrat e rrezikshme të paketuara në sasi të përjashtuara);

vi. 2.2.62.1.5; 2.2.7.1.2 (veprimtaritë që lidhen me sasitë në çdo njësi transporti, subjekt në përjashtimet sipas pikave të përmendura);

d) dispozitat e këtij udhëzimi për transportin me hekurudhë (referuar RID-it), nuk zbatohen për subjektet e transportit, në rastet e përjashtimeve, sipas:

i. 1.1.3.1, në lidhje me natyrën e operacioneve të transportit;

ii. 1.1.3.2, në lidhje me transportin e gazit;

iii. 1.1.3.3, në lidhje me transportin e karburanteve të lëngëzuara;

iv. disa mallra të rrezikshme të paketuara, në sasi të kufizuara apo të përjashtuara, plotësojnë kushtet që parashikohen në kapitujt 3.4 ose 3.5, në përputhje me kapitullin 1.1.4.2 ose 1.1.3.4.3;

v. 1.1.3.5, në lidhje me transportin e paketimeve të papastra bosh të lëngëzuara;

vi. disa mallra të rrezikshme të klasës 6.2 plotësojnë kushtet e parashikuara në klasën 2.2.62.1.5; ose

vii. disa materiale radioaktive, që plotësojnë kushtet e parashikuara, në përputhje me kapitullin 1.7.1.4.

Neni 6

Detyrat e këshilltarit të sigurisë

Detyrat e këshilltarit të sigurisë për monitorimin e praktikave dhe të procedurave, në lidhje me veprimtaritë përkatëse të subjektit, në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it, si dhe modelet e raportit mbi ngjarjet gjatë transportit të mallrave të rrezikshme brenda vendit dhe raportit vjetor të këshilltarit të sigurisë, në vijim të përcaktimeve të nenit 29, të ligjit për transportin e mallrave të rrezikshme, përshkruhen me detaje përkatësisht në aneksin I, aneksin VI dhe aneksin VII të këtij udhëzimi.

Neni 7

Certifikata e trajnimit e këshilltarit të sigurisë

1. Certifikata e trajnimit do të ketë formatin e përcaktuar në aneksin III dhe me afat vlefshmërie për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e lëshimit.

2. Një person mund të pajiset me një certifikatë trajnimi, sipas pikës 7.1, vetëm në rastet, kur:

a) ka përfunduar trajnimin; dhe

b) ka kaluar një testim, të miratuar me shkrim nga komisioni i caktuar nga autoriteti përgjegjës.

3. Nëse brenda një periudhe prej 12 muajsh përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë së certifikatës së trajnimit, referuar pikës 7.2, mbajtësi i kësaj certifikate kryen trajnimin rifreskues dhe kalon një testim, duke filluar nga data e përfundimit të certifikatës ekzistuese, vlefshmëria e certifikatës së trajnimit zgjatet edhe për një periudhë tjetër 5-vjeçare, duke filluar nga data e përfundimit të certifikatës ekzistuese. Zgjatja kryhet nga organi kompetent për kryerjen e trajnimit dhe të testimit.

4. Titulli i certifikatës duhet të tregojë qartë se ajo është e vlefshme vetëm për llojet e mallrave të rrezikshme të referuara në 1.8.3.12 të ADR-së dhe RID-it dhe, për të cilat këshilltari është testuar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, pika 1, të nenit 11, të këtij udhëzimi.

5. Kur trajnimi dhe testimi janë të kufizuar në një ose më shumë nga mënyrat e transportit ose të grupeve të mallrave të rrezikshme të përmendura në pikën 9, të aneksit II, kufizimi duhet të tregohet qartë në certifikatën e trajnimit të lëshuar në përputhje me pikën 7.1, të këtij udhëzimi.

Neni 8

Informacioni për organet e kontrollit në terren dhe autoriteteve përkatëse

1. Çdo subjekti, që i kërkohet nga ky udhëzim për të caktuar një apo disa këshilltarë të sigurisë, duhet:

a) të njoftojë brenda 15 ditëve kalendrike nga data e caktimit, autoritetin përgjegjës/autoritetin kombëtar të investigimit të aksidenteve dhe të incidenteve hekurudhore, për identitetin e këshilltarit/ve të sigurisë, si dhe për çdo ndryshim të mundshëm që ka lidhje me këtë/këta person/a.

b) të ofrojë një kopje të raportit të çdo aksidenti dhe të raportit vjetor, të cilat janë përgatitur në përputhje me këtë udhëzim, kur kjo kërkohet nga ministria, autoritetet përgjegjëse për sigurinë hekurudhore dhe kombëtare të investigimit të aksidenteve dhe të incidenteve hekurudhore ose nga personat e autorizuar të organeve të kontrollit.

2. Kur ndodh një aksident me pasojë dëme në persona, prona apo mjedis gjatë kryerjes së transportimit, shkarkimit ose ngarkimit të kryer nga subjekti, këshilltari i sigurisë, pas mbledhjes së të gjithë informacionit të nevojshëm, përgatit një raport mbi aksidentin për organet drejtuese të subjektit, si dhe për personat e autorizuar për kontroll, sipas neneve 30 dhe 39, të ligjit për transportin e mallrave të rrezikshme, për ministrinë e interesuara ose institucionet e tjera të ngarkuara me ligj, sa herë kërkohet prej tyre.

Neni 9

Trajnimi

(shtuar pikat 2.7, 2.8 dhe 2.9 me udhëzimin nr.14, datë 2.11.2023)

1. Trajnimi i përmendur në pikën 7.2 (a), të nenit 7, do të përfshijë njohuritë e mjaftueshme për rreziqet e qenësishme në transportin e mallrave të rrezikshme, kërkesat e dispozitave ligjore përkatëse, për aq sa ato lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme, detyrat e këshilltarit të sigurisë dhe funksionet e këshilltarit të sigurisë, siç është përcaktuar në aneksin I, në përputhje me ADR-në dhe RID-in (përkatësisht kapitujt 1.8.3.3).

2. Trajnimi kryhet sipas programit mësimor të trajnimit bazuar në modelin e miratuar.

2.1 Qëllimi i zbatimit të programit model të miratuar është të japë njohuritë e duhura dhe/ose të përmirësojë ato për nivelin profesional brenda kualifikimeve ekzistuese të nevojshme për veprimtarinë profesionale të një këshilltari sigurie të transportit të mallrave të rrezikshme në trafikun kombëtar dhe ndërkombëtar;

2.2 Trajnimi fillestar parashikon rritjen e nivelit profesional, në kuadër të kualifikimeve ekzistuese dhe zhvillimin e kompetencave të nevojshme për veprimtarinë profesionale të këshilltarit të sigurisë;

2.3 Trajnimi rifreskues parashikon rritjen e nivelit profesional dhe zhvillimin e kompetencave të reja të nevojshme për veprimtarinë profesionale të këshilltarit të sigurisë dhe kryhet të paktën një herë në pesë vjet pas zotërimit të kompetencave të një konsulenti në trajnimin fillestar;

2.4 Programi i miratuar parashikon organizimin e veprimtarive edukative, teorike dhe praktike, që kandidatët të marrin njohuritë e nevojshme;

2.5 Kohëzgjatja e trajnimeve për kandidatët, si dhe lista e seksioneve të kursit të trajnimit, përcaktohen në përputhje me terminologjinë e ADR-së dhe RID-it, si dhe nga lista e temave;

2.6 Program model parashikon, gjithashtu, trajnime praktike, duke përfshirë kryesisht ndihmën e parë për viktimat, shuarjen e zjarrit dhe veprime të tjera që duhen ndërmarrë në rast të një aksidenti trafiku etj.

2.7 Mungesa e pjesëmarrjes në trajnim përbën shkak për moslejimin e kryerjes së testimit. Për këtë qëllim, evidentimi i pjesëmarrjes kryhet me nënshtkrimin nga kandidati të fletëve të regjistrimit ose në mënyrë elektronike.

2.8 Kandidatët që do të pajisen me Certifikatën e Këshilltarit të Sigurisë duhet të jenë me profesion inxhinierë mekanikë, inxhinierë kimistë dhe/ose inxhinierë naftë dhe gazë.

2.9 Numri minimal i kandidatëve për fillimin e kurseve të trajnimit të jetë 10 persona. Në raste të veçanta, ky numër mund të ndryshojë, në varësi të kërkesave të të interesuarve dhe të infrastrukturës së trajnimit (ambientet e trajnimit, trupa e trajnimit, etj.).

Neni 10

Kushtet për zbatimin e programit të trajnimit

1. Kushtet për zbatimin e programit duhet të sigurojnë arritjen e plotë të rezultateve të planifikuara të zhvillimit të programit, përputhshmërinë e formave, mjeteve dhe metodave të mësimdhënies me kategoritë e kandidatëve, duke pasur parasysh veçoritë e transportit të mallrave të rrezikshme.

2. Trajnimi teorik kryhet në klasa të pajisura, që plotësojnë kërkesat materiale, teknike, informative dhe metodologjike, si më poshtë:

a) kohëzgjatja e një ore të mësimëve teorike dhe praktike duhet të jetë 45 minuta;

b) personeli mësimor, që zbaton programet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e kualifikimit të përcaktuara për këtë personel, që zbaton programe profesionale, të specifikuara në udhëzuesit e kualifikimit për pozicionet përkatëse dhe/ose standardet profesionale, si dhe duhet të plotësojnë një nga kërkesat e mëposhtme:

i. të jetë mes personelit mësimor të përfshirë në organizimin dhe trajnimin e personelit shumë të kualifikuar në fushën e transportit rrugor, përfshirë transportin e mallrave të rrezikshme;

ii. të ketë një certifikatë të trajnimit të këshilltarit të sigurisë të transportit rrugor të mallrave të rrezikshme, të lëshuar në përputhje me këtë udhëzim.

3. Kushtet informative dhe metodologjike për zbatimin e programit përfshijnë:

a) planin mësimdhënës dhe tematik, sipas programit;

b) materialet dhe pajisjet metodologjike;

c) orarin e zhvillimit të kurseve.

4. Mbështetja materiale, teknike, informative dhe metodologjike e programit:

Pajisjet dhe mjetet mësimore
Një kompjuter
Projektor multimedial ose TV
Ekran (monitor, tabelë elektronike)
Materiale informative
Udhëzues studimi që përmbajnë materiale për trajnim në leksionet e specifikuara në programin model
Mund të paraqiten në formën e botimeve të shtypura, posterave, materialeve elektronike edukative, filmave tematikë, prezantimeve
Aneksi A dhe aneksi B të ADR-së dhe RID-it
Stenda informative

Neni 11

Testimet

1. Qëllimi i testimit konsiston nëse kandidati ka nivelin e nevojshëm të njohurive për kryerjen e funksioneve të detyrueshme të një këshilltari sigurie, sipas aneksit 1 të këtij udhëzimi (përkatësisht kapitulli 1.8.3.3 i ADR-së dhe RID-it), me qëllim pajisjen me certifikatë, sipas aneksit III (përkatësisht kapitulli 1.8.3.7 i ADR-së dhe RID-it), dhe duhet të përfshijë të paktën çështjet, si më poshtë:

a) njohuri mbi llojet e pasojave që mund të shkaktohen nga një aksident, që përfshin mallra të rrezikshme dhe njohuri mbi shkaqet kryesore të aksidenteve;

b) kërkesat në lidhje me mënyrën e transportit të përdorur sipas ligjit kombëtar, konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, në mënyrë të veçantë, si më poshtë:

- i. klasifikimi i mallrave të rrezikshme (procedura për klasifikimin e solucioneve dhe të përzierjeve, struktura e listës të substancave, klasat e mallrave të rrezikshme dhe parimet e klasifikimit të tyre, natyra e mallrave të rrezikshme që transportohen, vetitë fizike, kimike dhe toksikologjike të mallrave të rrezikshme);
 - ii. dispozitat e përgjithshme të paketimit, dispozitat për cisterna, kontejnerët-cisternë (lloji, kodi, etiketimi, konstruksioni, testimi dhe inspektimi fillestar dhe periodik);
 - iii. kërkesat e paketimit dhe recetat për testimin e paketimit;
 - iv. shenjat e rrezikut dhe etiketat, dallimi i etiketave karakteristike të rrezikut me ngjyrë portokalli (markimi dhe etiketimi i paketave, vendosja/afishimi dhe heqja sipas rasteve specifike i etiketave me ngjyrë portokalli në anë të ndryshme të mjetit që transporton mallra të rrezikshme rifuxhio);
 - v. hollësi mbi dokumentet e transportit, deklarata e konformitetit të dërguesit etj.;
 - vi. metoda e dërgesës dhe kufizimet e dërgimit të ngarkesës (ngarkesë e plotë, transporti rifuxhio, transporti i ngarkesave me depozita mbi paleta, transporti me kontejnerë, transporti në tankera fikse dhe të lëvizshëm);
 - vii. transporti i udhëtarëve;
 - viii. ndalimet dhe marrja e masave paraprake në lidhje me ngarkesën e përzier;
 - ix. ndarja e substancave;
 - x. kufizimi për sasitë e transportuara dhe sasitë e përjashtuara;
 - xi. trajtimi dhe vendosja (ambalazhimi, mbushja, ngarkimi dhe shkarkimi, vendosja e ngarkesës sipas raportit për ekuilibrimin e saj dhe ndarja);
 - xii. pastrimi dhe/ose degazimi para ambalazhimit, mbushjes, ngarkimit dhe pas shkarkimit;
 - xiii. ekuipazhi dhe formimi profesional i tij;
 - xiv. dokumentet e mjeteve (dokumenti i transportit, udhëzimet me shkrim, certifikata e miratimit të mjeteve, certifikata e trajnimit e drejtuesve të mjeteve, kopje të çdo përjashtimi, dokumente të tjera);
 - xv. udhëzimet me shkrim të sigurisë (zbatimi i udhëzimeve dhe pajisjet mbrojtëse të drejtuesve të mjeteve/ekuipezhit e tyre);
 - xvi. detyrimet e mbikëqyrjes për parkim;
 - xvii. rregulloret dhe kufizimet mbi trafikun;
 - xviii. shkarkimet operative dhe aksidentale të ndotësve;
 - xvix. kërkesat në lidhje me pajisjet e transportit.
2. Organizimi, formulari i aplikimit, përgatitja dhe tarifat e testimit, jepen përkatësisht në aneksin II, aneksin VIII, aneksin IV, aneksin V të këtij udhëzimi.

Neni 12

Organi kompetent për kryerjen e trajnimit dhe testimit

(reformular pika 5 me udhëzimin nr.14, datë 2.11.2023)

1. Trajnimi dhe testimi i këshilltarëve të sigurisë të mallrave të rrezikshme në transportin:
 - a) rrugor, mbikëqyrjet nga autoriteti përgjegjës dhe kryhet nga organi i caktuar për këtë qëllim Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
 - b) hekurudhor, mbikëqyrjet nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore dhe do të kryhet në qendrat e formimit profesional.
2. Autoriteti përgjegjës në transportin e mallrave të rrezikshme miraton programet mësimore të zhvillimit të testimit, si dhe komisionin e caktuar për kryerjen e testimit, përbërja e të cilit propozohet nga institucioni i trajnimit ose organi i caktuar, me kusht që trupa e komisionit të jetë me përbërje të ndryshme nga trupa e trajnimit.
3. Miratimi i komisionit të testimit mund të jetë me kohëzgjatje të kufizuar dhe do të jetë bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - a) kompetenca e komisionit;

b) specififikimet e formës së testeve, që organi shqyrtues propozon, përfshirë, nëse është e nevojshme, infrastruktura dhe organizimi i testeve elektronike në përputhje me ADR-në dhe RID-in (përkatesisht kapitujt 1.8.3.12.5), nëse këto janë;

c) masat që synojnë të sigurojnë që testimet janë të paanshme; dhe

d) pavarësia e trupit nga të gjithë personat fizikë ose juridikë, që punësojnë këshilltarë sigurie në transportin hekurudhor.

4. Komisioni i testimit përbëhet nga tre persona, me eksperiencë mbi pesë vjet në fushën e transportit, të cilët janë njohës shumë të mirë të fushës së transportit të mallrave dhe në mënyrë të veçantë hartuesit e legjislacionit të transportit të mallrave të rrezikshme me rrugë dhe hekurudhë në zbatim të ADR-së dhe RID-it. Anëtarët e komisionit përcaktohen me urdhër të veçantë të ministrit.

5. Komisioni i testimit përgatit detyrat me shkrim për testimin, informon kandidatët për këshilltarë sigurie mbi procedurën e zhvillimit të testimit, zhvillon testimin dhe pas shqyrtimit të rezultateve të tij, ua komunikon kandidatëve, si dhe plotëson dokumentacionin përkatës.

Neni 13

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Trajnimi, testimi dhe lëshimi i certifikatave të trajnimit për këshilltarët e sigurisë në transportin e mallrave të rrezikshme, duhet të fillojë nga 1 korrik 2022.

Subjektet, të cilat kryejnë dhe marrin pjesë në transportin rrugor dhe hekurudhor të mallrave të rrezikshme duhet të caktojnë të paktën një këshilltar sigurie, jo më vonë se 31.12.2022.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

ANEKSI I DETYRAT E KËSHILLTARIT TË SIGURISË

1. Këshilltari i sigurisë për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, ka këto detyra në mënyrë të veçantë:

a) monitorimi i përputhshmërisë me rregullat, që kanë të bëjnë me transportin e mallrave të rrezikshme;

b) këshillimi i subjekteve mbi transportin e mallrave të rrezikshme;

c) përgatitjen e një raporti vjetor për strukturat drejtuese të subjektit ose për ndonjë autoritet publik qendror ose vendor, sipas nevojës, për veprimtaritë e subjektit në transportin e mallrave të rrezikshme.

2. Detyrat e detajuara janë, si më poshtë vijon:

a) Monitorimet e veprimtarisë mund të ndërmerren nga këshilltari i sigurisë, personalisht ose nga ata të emëruar nga ai ose punëdhënësi. Sidoqoftë, këshilltari i sigurisë duhet të shohë rezultatet e monitorimeve dhe të vendosë se cilat çështje/sendë kërkojnë veprim dhe të përcaktojë se cilat prej tyre mund t'u delegohen të tjerëve:

i. Procesi i monitorimit duhet të shihet si ciklik dhe të kryhet në rendin vijues:

- kontrolli;

- raporti;

- ndërmarrja e veprimeve që do të kryhen (përfshirë afatet kohore);

- rimonitorim;

- raporti;

- ndërmarrja e veprimeve të mëtejshme që do të kryhen.

ii. Frekuenca e ciklit dhe afati kohor për veprim varet nga:

- cilat shkelje të rregulloreve identifikohen;

- cilat rreziqe janë identifikuar, e kombinuar me një vlerësim të rrezikut që shkakton një aksident (p.sh. në këtë kontekst një rrezik është diçka që ka potencialin të shkaktojë dëm etj.);

- numri i veprimeve të identifikuar;
- madhësia e operacionit dhe numri i mallrave të transportuara, gjithashtu mund të ketë një ndikim në frekuencën e vizitave.

iii. Monitorimi i praktikave dhe i procedurave në vijim, që kanë të bëjnë me veprimtaritë përkatëse të subjektit:

- procedurat në përputhje me kërkesat që rregullojnë identifikimin e mallrave të rrezikshme gjatë transportimit;

- çdo kërkesë të posaçme që do të duhet të marrë parasysh subjekti në lidhje me blerjet e mjeteve të transportit, në rastet kur transportohen mallra të rrezikshme;

- procedurat për kontrollin e pajisjeve të përdorura në lidhje me transportin, ngarkimin ose shkarkimin e mallrave të rrezikshme;

- trajnimin e duhur të punonjësve të subjektit, duke përfshirë dhe ndryshimet në rregullore, si dhe mirëmbajtjen e regjistrave të trajnimeve të kryera;

- zbatimin e procedurave të duhura emergjente, në rast të ndonjë aksidenti apo incidenti, që mund të ndikojë në sigurinë gjatë transportit, ngarkimit ose shkarkimit të mallrave të rrezikshme;

- hetimin dhe, kur është e përshtatshme, përgatitjen e raporteve për aksidentet serioze, incidentet ose shkeljet e rënda të regjistruara gjatë transportit, paketimit, mbushjes, ngarkimit ose shkarkimit të mallrave të rrezikshme;

- zbatimin e masave të duhura për të shmangur përsëritjen e aksidenteve, incidenteve ose shkeljeve të rënda;

- masat që do të zbatojë subjekti për të përmbushur çdo detyrim ligjor dhe kërkesë të posaçme, që lidhet me transportin e mallrave të rrezikshme, sa herë që subjekti përzgjedh dhe përdor nënkontraktorë ose palë të treta;

- verifikimin që punonjësit e përfshirë në transportin, paketimin, mbushjen, ngarkimin ose shkarkimin e mallrave të rrezikshme të kenë procedura dhe udhëzime të detajuara operationale;

- prezantimin e masave për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e qenësishme në transportin, paketimin, mbushjen, ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave të rrezikshme;

- zbatimin e procedurave të verifikimit, për të siguruar:

- praninë në bord të dokumenteve të mjeteve të transportit dhe pajisjeve të sigurisë, të cilat duhet të shoqërojnë transportin dhe përputhshmërinë e këtyre dokumenteve dhe pajisjeve me rregulloret;

- përputhshmërinë me kërkesat, që kanë të bëjnë me paketimin, mbushjen, ngarkimin dhe shkarkimin;

- ekzistenca e planit të sigurisë, pjesë e marrëveshje midis këshilltarit të sigurisë dhe punëdhënësit (kapitujt 1.10.3.2. të ADR-së dhe RID-it).

b) Këshilltari i sigurisë mund të jetë, gjithashtu, drejtues i subjektit një person me detyra të tjera në subjekt ose një person që nuk është i punësuar drejtpërdrejt nga ai subjekt, me kusht që ai person të jetë i aftë të performojë detyrat e këshilltarit të sigurisë për transportin rrugor dhe/ose hekurudhor të mallrave të rrezikshme.

c) Këshillimi i këshilltarit të sigurisë për subjektin ose punëdhënësin duhet, kur është e zbatueshme, të fokusohet në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme, veçanërisht kur:

i. Duke marrë parasysh një mënyrë tjetër ose sistem kontrolli që nuk është përdorur më parë. *(Shënim. Këshilltarët e sigurisë duhet të sigurojnë që ata të mos japin këshilla për mënyrat e transportit, nëse nuk janë të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme për atë mënyrë.)*

ii. Llojet e reja të mallrave të rrezikshme që do të transportohen. *(Shënim. Këshilltarët e sigurisë duhet të sigurojnë që ata të mos japin këshilla për klasat, nëse nuk janë të trajnuar si duhet për ta dhënë atë këshillë.)*

iii. Duhet të kërkojë këshilla të jashtme, nëse është e nevojshme.

d) Raportet vjetore duhet të hartohen deri në tre muaj pas përfundimit të vitit paraardhës dhe të ruhen në një vend të sigurt për të paktën pesë vjet, si dhe të vihen në dispozicion të autoriteteve publike me kërkesë të tyre. Përmbajtja e raportit vjetor është një çështje për marrëveshje midis këshilltarit të sigurisë dhe punëdhënësit (në varësi të vendimit të tyre).

e) Më poshtë është një listë e çështjeve të sugjeruara për shqyrtim për t'u përfshirë në raportin vjetor:

- i. tonazhi total i mallrave të rrezikshme të transportuar gjatë vitit;
- ii. sistemet e ndryshme të kontrollit të përdorura;
- iii. tonazhi i kryer nga çdo mënyrë transporti;
- iv. klasat e mallrave të rrezikshme të transportuara dhe përqindja e ndarë sipas tonazhit;
- v. numri i përgjithshëm i aksidenteve që lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme, duke përfshirë detajet e shifrës së vitit të kaluar;
- vi. një analizë e numrit të aksidenteve për mënyrën e transportit dhe për sistemin e kontrollit, duke përfshirë detajet e shifrave të vitit të kaluar;
- vii. një koment për çdo shkak të zakonshëm të aksidenteve, p.sh. gabimi i stafit, dështimi mekanik ose defektet në sistemet e kontrollit;
- viii. numri i njoftimeve për ndjekje administrative, penale dhe/ose ndalime ose paralajmërime të tjera zyrtare me një krahasim me vitin e kaluar;
- ix. numri i monitorimeve të kryera me një krahasim me vitin e kaluar;
- x. emrat e personave të trajnuar dhe një përshkrim të shkurtër të trajnimit të dhënë, përfshirë trajnimin e këshilltarëve të sigurisë;
- xi. një koment për çdo arsye të identifikuar, pse performanca e sigurisë të vitit raportues është më e mirë ose më e keqe se viti i kaluar, si dhe çdo veprim i zbatuar ose i propozuar;
- xii. një përmbledhje dhe koment i veprimeve nga monitorimet e mëparshme.

f) Ky raport nuk do të zëvendësojë asnjë raport nga menaxhimi i subjektit⁵, që mund të kërkohej sipas ndonjë legjislacion tjetër ndërkombëtar ose kombëtar të zbatueshëm⁶.

3. Këshilltari i sigurisë duhet të kujdeset për trajnimin e personave, sipas pikës 8.2.3 të ADR-së, detyrat e të cilëve kanë të bëjnë me transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, që trajnohen nga subjekti përkatës i transportit, me kërkesat që rregullojnë transportin e mallrave të tilla të përshtatshme për përgjegjësitë dhe detyrat e tyre sipas kapitullit 1.3 të ADR-së.

Kërkesa për trajnim do të zbatohet për individët të tillë, si personeli që:

- i. janë të punësuar nga subjekti i transportit rrugor ose dërguesit;
- ii. ngarkojnë ose shkarkojnë mallra të rrezikshme;
- iii. dërgon mallrat ose agjencitë e transportit detar; dhe
- iv. drejtuesit e mjeteve, përveç drejtuesve të pajisur me një certifikatë, në përputhje me pikën 8.2.1 të ADR, të përfshirë në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme.

4. Nuk do të zbatohen kërkesat për subjektet hekurudhore, të cilat autoriteti i sigurisë hekurudhore përgjegjës për kontrollin në zbatim të rregullores RID, mund t'i parashikojë për veprimtaritë e përcaktuara në nenin 5, shkronjat "b" dhe "c".

ANEKSI II

ORGANIZIMI I TESTIMIT

(shtuar pika 10 me udhëzimin nr.14, datë 2.11.2023)

1. Testimi përbëhet nga një test me shkrim, i cili të mund të plotësohet nga një testim me gojë.
2. Autoriteti përgjegjës ose institucioni/organi i caktuar për testimin nga autoriteti përgjegjës do të mbikëqyrë dhe do të inspektojë çdo testim. Çdo manipulim dhe mashtrim do të përjashtohet për aq sa është e mundur dhe duhet të sigurohet vërtetimi i kandidatit. Përdorimi në testin me shkrim të dokumentacionit, përveç atij ndërkombëtar ose rregulloreve kombëtare, nuk lejohet.

Të gjitha dokumentet e testimit regjistrohen dhe ruhen të printuara ose elektronikisht si një dosje.

⁵ Subjektet/ sipërmarrjet hekurudhore, të cilat marrin pjesë në transportin e mallrave të rrezikshme, vetëm si dërgues, dhe të cilave nuk u është dashur të caktojnë një këshilltar sigurie në bazë të dispozitave të zbatueshme deri më tani, me përjashtim të dispozitave të zbatueshme të marrëveshjes ADR dhe rregullores RID, referuar në kap. 1.8.3.1, do të caktojnë një këshilltar të sigurisë jo më vonë se 31 dhjetor 2022.

⁶ Palët mund të vazhdojnë të lëshojnë certifikata trajnimi për këshilltarët e sigurisë së mallrave të rrezikshme, konform modelit të zbatueshëm në rend shterues, në vend të atyre që përputhen me kërkesat e marrëveshjes ADR dhe rregullores RID (kapitujt 1.8.3.18) të zbatueshëm nga 1 janari i viti pasardhës, deri në atë fundviti. Certifikatat mund të vazhdojnë të përdoren deri në fund të vlefshmërisë së tyre prej 5 vjetësh.

3. Media elektronike mund të përdoret vetëm nëse ofrohet nga organi shqyrtues. Kur nuk do të ketë asnjë mjet të tillë, një kandidati, prezantimi i të dhënave të mëtejshme në medien elektronike nuk i është siguruar; kandidati mund t'u përgjigjet vetëm pyetjeve të paraqitura.

Gjithashtu, gjatë testimit, mund të lejohet të procedohet me *libër hapur*, që nënkupton se lejohet të merren disa tekste në ambientet e testeve, por që në testimin me shkrim është e lejueshme përdorimi vetëm i dokumenteve, të cilat janë në kuadrin ligjor ndërkombëtar apo kombëtar përkatës.

4. Testimi me shkrim, në formë elektronike, konsiston në dy pjesë:

a) Kandidatët do të marrin një pyetësor, i cili përfshin 20 pyetje të hapura, që mbulojnë minimalisht çështjet e cituara në aneksin II (përkatësisht kapitujt 1.8.3.11 të ADR-së dhe RID-it). Megjithatë, mund të përdoren pyetje me alternativa. Në këtë rast, dy pyetje me alternativa kanë vlerën e një pyetjeje të hapur.

Midis këtyre çështjeve, rëndësi të veçantë duhet t'u kushtohet çështjeve, si më poshtë:

- i. masat e përgjithshme parandaluese dhe ato të sigurisë;
- ii. klasifikimi i mallrave të rrezikshme;
- iii. masat e përgjithshme për paketimin, duke përfshirë cisternat, cisternat- kontejner etj.;
- iv. etiketat e rrezikut;
- v. informacionet mbi dokumentet e transportit;
- vi. trajtimi dhe vendosja;
- vii. ekuipazhi, trajnimet profesionale, dokumentacioni i mjetit të transportit dhe certifikatat e transportit;
- viii. instruksione me shkrim;
- ix. kërkesat në lidhje me mjetet/pajisjet e transportit.

b) Kandidatët do të kryejnë një rast studimor, në lidhje me detyrat e këshilltarit të referuara në aneksin I (kapitujt 1.8.3.3 të ADR-së dhe RID-it), në mënyrë që të demonstrojnë kualifikimin e nevojshëm në përmbushjen e tyre.

5. Testimet me shkrim mund të kryhen, plotësisht ose pjesërisht, si teste elektronike, ku përgjigjet regjistrohen dhe vlerësohen, duke përdorur proceset elektronike të përpunimit të të dhënave (PEP/EDP), me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Hardueri dhe softueri do të kontrollohen dhe do të pranohen nga autoriteti kompetent ose nga një organ ekzaminues i caktuar nga autoriteti kompetent.

b) Funksionimi i duhur teknik duhet të sigurohet. Marrëveshjet se si testimi mund të vazhdojë do të bëhen për një dështim të pajisjeve dhe të aplikacioneve. Asnjë ndihmë nuk do të jetë në dispozicion në pajisjet e hyrjes (p.sh. funksioni i kërkimit elektronik), pajisja e siguruar sipas ADR-së dhe RID-it (kapitujt 1.8.3.12.3) nuk do të lejojë që kandidatët të komunikojnë me ndonjë pajisje tjetër gjatë testimit.

c) Të dhënat përfundimtare të secilit kandidat regjistrohen. Përcaktimi i rezultateve do të jetë transparent dhe do të shpallet me mjetet e komunikimit e të njoftimit. Autoriteti përgjegjës në transportin e mallrave të rrezikshme/institucioni i trajnimit, si qendër formimi, mban një regjistër të listës së pyetjeve që janë përfshirë në testim.

d) Testimi konsiderohet i fituar nëse kandidati është përgjigjur saktë së paku shtatëdhjetë e pesë për qind të pyetjeve të parashtruara, si dhe nuk ka bërë gabime gjatë kryerjes së detyrës praktike.

e) Në bazë të rezultateve të testimit, komisioni i testimit harton procesverbalin e mbledhjes së komisionit të testimit për çdo kandidat për këshilltar sigurie.

f) Kandidati për këshilltar sigurie, i cili nuk e ka dhënë testimin ose nuk e ka fituar atë, mund t'i nënshtrohet sërish testimit deri në tri herë brenda një viti nga aplikimi.

g) Data dhe ora për përsëritjen e testimit përcaktohet dhe i komunikohet kandidatit për këshilltar sigurie nga organi i caktuar.

6. Testim i njohurive të kërkuara, sipas ADR-së dhe RID-it (kapitulli 1.8.3.11.b), do të përfshijë ndryshimet në rregulloret përkatëse të prezantuara, që nga dhënia e certifikatës së fundit.

7. Testimi do të mbahet dhe mbikëqyret sipas ADR-së dhe RID-it (kapitujt 1.8.3.10 dhe 1.8.3.12 deri 1.8.3.14). Sidoqoftë, mbajtësi i kësaj certifikate nuk ka nevojë të ndërmarrë çështjen në fjalë në mënyrë të specifikuar në ADR dhe RID (kapitulli 1.8.3.12.4.b).

(Shënim. Mund të parashikohen rastet specifike për subjektet, që kryejnë transportimin e disa kategorive të mallrave të rrezikshme, për rrjedhojë dhe testimi mund të kryhet vetëm për këto raste specifike, gjithashtu dhe certifikata do të provojë se është e vlefshme vetëm për disa kategori të mallrave të rrezikshme.)

8. Transferimi i dijenive në progresin bashkëkohor dhe teknologjik në testim, bën që kandidati i paraqitur për këshilltar të siguri së hekurudhore dhe të kombinuar duhet të provojë aftësinë e tij dhe përfaqësuesit e transportit, që mbulojnë këtë fushë:

a) në përmbushjen e qëllimit të testimit të njohurive të marra gjatë trajnimit, në ofrimin ndaj kandidatëve për këshilltar sigurie hekurudhore, të njohurive të mjaftueshme për rreziqet e natyrshme në transportin, paketimin, mbushjen, ngarkimin ose shkarkimin e mallrave të rrezikshme, të ligjeve, të rregulloreve në zbatim dhe dispozitat administrative, si dhe detyrave të renditura në ADR dhe RID (kapitujt 1.8.3.3.1–50);

b) sipas ADR-së dhe RID-it mund të vendoset që, kandidatët që synojnë të punojnë për subjekte të specializuara në transportin e llojeve të caktuara të mallrave të rrezikshme, duhet të vihet në testim vetëm për substancat që lidhen me fushat e tyre te veprimtarisë në fushën e transportit të mallrave të rrezikshme.

9. Trajnimi dhe testimet zhvillohen, lidhur me:

a) transportin rrugor, hekurudhor dhe të kombinuar;

b) transportin e:

i. të gjitha mallrave të rrezikshme; ose

ii. një ose më shumë nga grupet e mëposhtme të mallrave të rrezikshme:

- klasa 1 (eksplozivët/lëndët plasëse);

- klasa 2 (gazet);

- klasa 7 (materialet radioaktive);

- klasa 3, 4.1, 4.2, 4.3, 5.1, 5.2, 6.1, 6.2, 8 dhe 9 (të ngurtat dhe lëngjet);

- numrat UN Nos. 1202, 1203, 1223, 3475 dhe karburanti i aviacionit, klasifikuar UN Nos. 1268 ose 1863 (vajrat minerale).

10. Për rinovimin e certifikatës së trajnimit, kandidatët do të marrin një pyetësor, i cili përfshin 20 pyetje të hapura, që mbulojnë minimalisht çështjet e cituara në këtë aneks (përkatësisht kapitujt 1.8.11 të ADR-së). Si dhe bazuar në programin përkatës të trajnimit të përcaktuar në këtë udhëzim.

ANEKSI III

(Në përputhje me modelin e marrëveshjes ADR dhe rregullores RID, përkatësisht, kapitulli 1.8, pika 1.8.3.18)

FORMATI I CERTIFIKATËS

CERTIFIKATË E TRAJNIMIT SI KËSHILLTAR I SIGURISË PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME

Nr. i certifikatës:

Shenjë dalluese e shtetit/autoritetit që lëshon certifikatën:

Mbiemri:

Emri:

Data dhe vendi i lindjes:

Kombësia:

Nënshkrimi i mbajtësit:

I vlefshëm deri më për subjektet që transportojnë mallra të rrezikshme dhe për subjektet, të cilat kryejnë ngarkim ose shkarkim përkatësisht:

me rrugë

me hekurudhë

nëpërmjet ujërave të brendshme

Lëshuar nga:

Data:

Nënshkrimi:

ANEKSI IV

Përgatitja e testimit sipas udhëzimit

2 ditë

(Orari 9:00–17:00)

- Detyrimet e këshilltarit të sigurisë;
- Klasifikimi i mallrave të rrezikshme;
- Procedura e klasifikimit të zgjidhjeve dhe të përbërësve;
- Struktura e renditjes së masës;
- Klasat e mallrave të rrezikshme dhe parimet e klasifikimit;
- Dokumentet e udhëtimit;
- Regjimi i shkarkimit;
- Transporti emergjent;
- Shkaqet dhe pasojat e aksidenteve;
- Shënimi i etiketave të rrezikut;
- Kushtet e përgjithshme të ambalazhimit (paketimit);
- Kërkesat lidhur me ambalazhet dhe përshkrimet e përshtatshme të provave mbi ambalazhet.

3–4 ditë

Orari 9:00–17:00

- Mjetet, kontejnerët, cisternat dhe mjete të tjera të depozitimit dhe transportit të mallrave të rrezikshme, karakteristikat konstruktive, aprovimi dhe kontrollet periodike;
- Verifikimi i përshtatjes me transportin dhe përdorimin e mjeteve, mjetet-cisterna dhe kontejner;
- Procedurat e lavazhit;
- Ushtrime mbi materialet e testimit.

Programi i trajnimit fillestar

Nr.	Seksionet (temat) e kursit	Numri i orëve mësimore		
		Total	duke përfshirë	
			teori	praktikë
1	Rëndësia socioekonomike e problemit të sigurimit të sigurisë në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme	2	2	-
2	Rregullimi ligjor i transportit të mallrave të rrezikshme në trafikun e brendshëm dhe ndërkombëtar	2	2	-
3	Funksionet dhe kualifikimet për këshilltarët e sigurisë në transportin e mallrave rrezikshme	1	1	
4	Klasifikimi, karakteristikat e përgjithshme të mallrave të rrezikshme dhe llojet e rrezikut gjatë transportit të tyre	5	4	1
5	Kërkesat e përgjithshme për mjetet, ambalazhet, kontejnerët dhe cisternat për transportin e mallrave të rrezikshme	3	3	-
6	Kërkesat për automjetet dhe pajisjet shtesë për transportin e mallrave të rrezikshme	4	3	1
7	Shenjat portokalli, shenjat e rrezikut, tabelat dhe pllakat e informacionit	3	2	1
8	Përrjashtimet, kufizimet dhe çështjet e përputhshmërisë për transportin e mallrave të rrezikshme	3	2	1
9	Metodat dhe organizimi i transportit rrugor dhe multimodal	3	2	1
10	Detyrimet dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në transportin e mallrave të rrezikshme dhe kontrolli mbi pajtueshmërinë me kërkesat e përcaktuara	3	2	1
11	Masat parandaluese për të garantuar sigurinë gjatë transportit dhe trajtimit	4	3	1
12	Veprimet e drejtuesit dhe të ekuipazhit në rast aksidentesh dhe incidentesh gjatë transportit të mallrave të rrezikshme	3	2	1
13	Transport me shoqërues dhe leje për transportin e mallrave të rrezikshme me shoqërim.	2	1	1
14	Hartimi i planit të sigurisë dhe raportit vjetor të subjekteve për transportin e mallrave të rrezikshme	4	2	2
	Totali i orëve mësimore	42	31	11

Programi i trajnimit rifreskues

Nr.	Seksionet (temat) e kursit	Numri i orëve mësimore		
		Total	duke përfshirë	
			teori	praktikë
1	Rëndësia socioekonomike e problemit të sigurimit të sigurisë në transportin rrugor të mallrave të	1	1	-

	rrezikshme			
2	Rregullimi ligjor i transportit të mallrave të rrezikshme në trafikun të brendshëm dhe ndërkombëtar	1	1	-
3	Funksionet dhe kualifikimet për këshilltarët e sigurisë në transportin e mallrave rrezikshme	-	-	-
4	Klasifikimi, karakteristikat e përgjithshme të mallrave të rrezikshme dhe llojet e rrezikut gjatë transportit të tyre	3	2	1
5	Kërkesat e përgjithshme për mjetet, ambalazhet, kontejnerët dhe cisternat për transportin e mallrave të rrezikshme	3	2	1
6	Kërkesat për automjete dhe pajisje shtesë për transportin e mallrave të rrezikshme	2	1	1
7	Shenjat portokalli, shenjat e rrezikut, tabelat dhe pllakat e informacionit	1	1	-
8	Përjashtimet, kufizimet dhe çështjet e përputhshmërisë për transportin e mallrave të rrezikshme	1	1	-
9	Metodat dhe organizimi i transportit rrugor dhe multimodal	2	1	1
10	Detyrimet dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në transportin e mallrave të rrezikshme dhe kontrolli mbi pajtueshmërinë me kërkesat e përcaktuara	2	1	1
11	Masat parandaluese për të garantuar sigurinë gjatë transportit dhe trajtimit	3	2	1
12	Veprimet e drejtuesit dhe ekuipazhit në rast aksidentesh dhe incidentesh gjatë transportit të mallrave të rrezikshme	2	1	1
13	Transport me shoqërues dhe leje për transportin e mallrave të rrezikshme me shoqërim	2	1	1
14	Hartimi i planit të sigurisë dhe raportit vjetor të subjekteve për transportin e mallrave të rrezikshme	3	2	1
	Totali i orëve mësimore	26	16	9

ANEKSI V TARIFAT

Tarifa e certifikatës së trajnimit:

Nr.	Tarifat e detajuara	Lekë
1	Regjistrimi i kandidatit për trajnim	500
2	Çdo orë leksioni	400
3	Ritestimi i njohurive	600
4	Dublikata	800
5	Lëshimi i certifikatës	3600

ANEKSI VI

Raporti mbi ngjarjet gjatë transportit të mallrave të rrezikshme brenda vendit, në përputhje me kapitullin 1.8.5 të marrëveshjes ADR dhe të rregullores RID

Subjekti/transportuesi/operatori/sipërmarrësi i infrastrukturës
hekurudhore:.....

Adresa:.....

Emri i kontaktit: Telefon: E-mail:

Autoriteti përgjegjës do ta heqë këtë para dërgimit të raportit

1. Mënyra						
☐ Hekurudhë Numri i vagonit (opsional)			☐ Rrugë Regjistrimi i mjetit (opsional)			
2. Data dhe vendi i ngjarjes						
Viti: Muaji: Dita: koha:						
<u>Hekurudhë</u> ☐ Stacioni ☐ Manovrimi/stacioni i përzgjedhjes ☐ Vendi i ngarkimit/shkarkimit/transportimit Vendndodhja/vendi: ☐ Linjë e hapur: Përshkrimi i linjës: Kilometrat:			<u>Rrugë</u> ☐ Zonë e ndërtuar ☐ Vendi i ngarkimi/shkarkimi/ndërrimit/transportimit ☐ Rrugë e hapur Vendndodhja/vendi:			
3. Topografia						
☐ Gradienti/pjerrësia ☐ Tuneli ☐ Urë/nënkallim ☐ Kryqëzim						
4. Kushtet e veçanta të motit						
☐ Shi ☐ Borë ☐ Akull ☐ Mjegull ☐ Stuhi e përkohshme ☐ Stuhi Temperatura: °C						
5. Përshkrimi i ngjarjes						
☐ Rrëzim/dalja nga rruga						
☐ Përplasje						
☐ Përmbysje/rrokullisje						
☐ Zjarr						
☐ Shpërthim						
☐ Humbje						
☐ Defekt teknik						
Përshkrimi shtesë i ngjarjes:						
.....						
.....						
.....						
.....						
.....						
.....						
.....						
6. Mallrat e rrezikshme të përfshira						
UN Numër ⁽¹⁾	Klasa	Grupi i paketimit	Sasia e vlerësuar e sasisë së humbur të produkteve (kg ose l) ⁽²⁾	Mjetet e mbajtjes ⁽³⁾	Materiali i mjeteve mbajtëse	Lloji i humbjes së mjeteve mbajtëse ⁽⁴⁾

(1) Për mallrat e rrezikshme të caktuara për hyrje kolektive, në të cilat zbatohet dispozita e veçantë 274, duhet të tregohet edhe emri teknik			(2) Për klasën 7 tregon vlerën në përputhje me kriterin 1.8.5.3.			
(3) Tregoni numrin e përshtatshëm 1. Paketimi 2. IBC 3. Paketimi i gjerë 4. Kontejner i vogël 5. Vagon 6. Mjet 7. Vagon-Cisternë 8. Mjet-Cisternë 9. Vagon-Bateri 10. Mjet-bateri 11. Vagon me cisterna të çmontueshme 12. Cisternë e Çmontueshme 13. Kontejner i gjerë 14. Cisterna-kontejner 15. MEGC 16. Cisterna portabël			(4) Tregoni numrin e përshtatshëm 1. Humbje 2. Zjarr 3. Shpërthim 4. Dëme strukturore			
7. Shkakun e ndodhjes (nëse dihet qartë)						
☐ Gabime teknike						
☐ Sigurim (fiksimi) i gabuar i ngarkesës						
☐ Shkak operacional (operimi me hekurudhë)						
☐ Të tjera:						
.....						
.....						
.....						
8. Pasojat e ngjarjes						
<u>Dëmtim fizik në lidhje me mallrat e rrezikshme të përfshira:</u>						
☐ Vdekjet (numri: ...)						
☐ Dëmtime trupore (numri: ...)						
<u>Humbja e produktit:</u>						
☐ Po						
☐ Jo						
☐ Rreziku i menjëhershëm dhe/ose i pashmangshëm i humbjes së produktit						
<u>Dëmet materiale dhe mjedisit:</u>						
☐ Niveli i vlerësuar i dëmit ≤ 50,000 euro						
☐ Niveli i vlerësuar i dëmit > 50,000 euro						
<u>Ndërhyrja e autoriteteve:</u>						
☐ Po ☐ Evakuimi i personave për një kohëzgjatje të paktën tre orë të shkaktuara nga mallrat e rrezikshme të përfshira.						
☐ Mbyllja e trafikut publik për një kohëzgjatje të paktën për tre orë të shkaktuara nga mallrat e rrezikshme të përfshira.						
☐ Jo						

Nëse është e nevojshme, autoriteti përgjegjës mund të kërkojë informacion plotësues të mëtejshëm.

ANEKSI VII RAPORTI VJETOR I KËSHILLTARIT TË SIGURISË

RAPORTI VJETOR I KËSHILLTARIT TË SIGURISË SË MALLRAVE TË RREZIKSHME	
1. Për periudhën:	
2. Raport në lidhje me veprimtaritë brenda fushës të:	☐ Marrëveshjes ADR ☐ Rregullores RID

3. Identifikim i plotë i subjektit me të cilin lidhet ky raport/ose për të cilin hartohet ky raport (detajet e kontaktit):									
4. Kanë mospërputhje me kërkesat që rregullojnë transportin e mallrave të rrezikshme, të cilat kanë qenë të identifikuar nga këshilltari i sigurisë:		☐ Po (Për detajet shiko aneksin)				☐ Jo			
5. Mënyra e transportit:		☐ në paketa		☐ në cisterna		☐ në volum (masë)			
6. Informacionin mbi llojin operacioneve të transportit dhe sasi të mallrave të rrezikshme									
Klasa	Lloji i operacioneve të transportit						Sasi të (t/vit)		
	Dërgimi	Transporti	Paketimi	Ngarkimi	Mbushja	Shkarkimi	5-50	50-1000	>1000
1									
2									
3									
4.1									
4.2									
4.3									
5.1									
5.2									
6.1									
6.2									
7									
8									
9									
7. Praktikat dhe procedurat									
	Praktikat dhe procedurat					Po	Jo	N/A	
7.1	A ekzistojnë procedurat për përpunimin me kërkesat që rregullojnë identifikimin e mallrave të rrezikshme që transportohen?								
7.2	A merren parasysh në praktikën e subjektit, kur blejnë mjetet e transportit, ndonjë kërkesë e veçantë, në lidhje me mallrat e rrezikshme që transportohen?								
7.3	A ekzistojnë procedurat për kontrollimin e pajisjeve të përdorura në lidhje me transportin, paketimin, mbushjen, ngarkimin ose shkarkimin e mallrave të rrezikshme?								
7.4	A janë të trajnuar siç duhet punonjësit e subjektit dhe a mbahen shënime të një trajnimit të tillë?								
7.5	A janë procedurat e duhura të emergjencës për rastin e ndonjë aksidenti ose incidenti, që mund të ndikojë në sigurinë gjatë transportimit, paketimit, mbushjes, ngarkimit ose shkarkimit të mallrave të rrezikshme?								
7.6	A ka hetime dhe, kur është e përshtatshme, përgatiten raporte për aksidentet, incidentet apo shkeljet serioze të regjistruara gjatë transportimit, paketimit, mbushjes, ngarkimit ose shkarkimit të mallrave të rrezikshme?								
7.7	A janë zbatuar masa të përshtatshme për të shmangur përsëritjen e aksidenteve, incidenteve apo shkeljeve serioze?								
7.8	A janë marrë parasysh kërkesat e ligjore dhe kërkesat e veçanta që lidhen me transportimin, paketimin, mbushjen, ngarkimin ose shkarkimin e mallrave të rrezikshme, në zgjedhjen dhe përdorimin e nënkontraktuesve ose palëve të treta?								
7.9	A kanë punonjësit e përfshirë në transportimin, paketimin, mbushjen, ngarkimin ose shkarkimin e mallrave të rrezikshme procedura dhe instruksione operacionale të detajuara?								
7.10	A janë prezantuar masa për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e qenësishme në transportimin, paketimin, mbushjen, ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave të rrezikshme?								

7.11	A janë zbatuar procedurat për të siguruar praninë në mjetet e transportit të dokumenteve dhe pajisjeve të sigurisë, të cilat duhet të shoqërojnë transportin dhe përputhja e këtyre dokumenteve dhe pajisjeve me rregullat?			
7.12	A janë zbatuar procedurat për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat që rregullojnë paketimin, mbushjen, ngarkimin dhe shkarkimin?			
7.13	A ekziston një plan sigurie, siç përcaktohet në kapitullin 1.10.3.2 dhe të shpjeguara në detaje në pikat 1.10.3.2.1 dhe 1.10.3.2.2 të ADR-së dhe RID-it?			
8. Komente:				
9. Raporti i përgatit nga:				
Emri dhe mbiemri i këshilltarit	Kodi i certifikatës së këshilltarit	Nënshkrimi i këshilltarit	Data e përgatitjes	
Nënshkrimi i personit përgjegjës të subjektit _____ <i>(Emër, mbiemër dhe firmë)</i>				

ANEKSI VIII
FORMULARI I APLIKIMIT PËR TESTIMIN E KSMRR-së

202 ____ Testimi i Këshilltarit të Sigurisë të Mallrave të Rrezikshme
<u>Formulari i aplikimit</u> Lutemi lexoni udhëzimin me kujdes, para plotësimit të këtij modeli (vetëm në shkronja kapitale).
SEKSIONI A
*Titulli: * Emri: _____ *Mbiemri: _____ (zoti/zonja etj.)
*Adresa:
Emri i subjektit dhe adresa/*adresa dhe e-mail- i:
* Numri i telefonit: fiks/cel.: * Data e lindjes _____._____.
* Vendi i lindjes: * Nënshtetësia:
* Keni qenë më parë për një testim të KSMRR-së? Po ☐ Jo ☐
Nëse po, tregoni numrin tuaj të mëparshëm të kandidatit/certifikatës
Emri i ofruesit të kursit (nëse, aplikueshëm)
* Testimi/met që ju dëshironi të kryeni: BAZË TË GJITHË KLASAT
MËNYRA – RRUGORE/HEKURUDHORE
*Qendra e testimit: (Lutemi shiko shënimet sqaruese në fund.)
*Fusha detyruese për t'u plotësuar nga kandidati
<u>Formulari i paplotësuar nuk do të përpunohet dhe do t'i kthehet dërguesit.</u>
SEKSIONI B
*Nënshkrimi i kandidatit:
<i>Deklaroj nën përgjegjësinë time, në emër dhe për llogari të subjektit kërkues që përfaqësoj (nëse është i punësuar në atë subjekt), se:</i> a) të dhënat e deklaruara dhe dokumentet e dorëzuara janë të vërteta dhe brenda perindbës së vlefshmërisë; b) aplikuesi/subjekti nuk ka asnjë pengesë ligjore për të ushtruar veprimtarinë e kërkuar; c) aplikuesi/subjekti njeh dhe pranon kriteret dhe detyrimet e trajnimit, testimit dhe tarifat përkatëse. Jam në dijeni që: në rast se dokumentet për marrjen apo për të rinovuar certifikatën nuk dorëzohen _____ ditë brenda afatit të përcaktuar, unë humbas të drejtën e trajnimit, testimit dhe marrjes së certifikatës.
* Emri: _____ * Mbiemri: _____
* Nënshkrimi: _____ * Adresa: _____
SHËNIM. Kur një seksion është shënuar me * është e detyrueshme të plotësohet ose formulari i aplikimit nuk do të pranohet për shqyrtim dhe do t'i kthehet kërkuesit.